




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, shkronja d, neni 17 dhe neni 40, shkronja c të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 9 të Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2, e datës 15 Shkurt 2018), nenin 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 27.11.2023 merr këtë:

V E N D I M

për caktimin e normave tatimore për tatimin për pronat e paluajtshme për vitin 2024

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për caktimin e normave tatimore për vitin 2024 për të gjitha kategoritë e pronave në tërë Komunën e Vitisë, me përjashtim të kategorisë pronë publike dhe përjashtimeve tjera sipas legjislacionit përkatës, më sa vijon:

Normat tatimore sipas këtij neni caktohen konform Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9 paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 deri në 1.9 dhe Ligjit Nr.08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

Në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, pika 1 si dhe pikat 1.1 për njësitë bujqësore të parcelave, 1.2 për njësitë bujqësore të objekteve, 1.3 për njësitë pyjore të parcelave, 1.4 për njësitë rezidenciale të parcelave, 1.5 për njësitë rezidenciale të objekteve, 1.8 për njësitë industriale të parcelave dhe 1.9 për njësitë industriale të objekteve, Kuvendi i Komunës së Vitisë cakton normat tatimore për vitin 2024 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë së pronave publike, me sa vijon:

- | | |
|--|-------|
| 1.1 Për njësitë bujqësore të parcelave----- | 0.15% |
| 1.2 Për njësitë bujqësore të objekteve----- | 0.15% |
| 1.3 Për njësitë e pyjeve të parcelave----- | 0.15% |
| 1.4 Për njësitë rezidenciale të parcelave----- | 0.15% |
| 1.5 Për njësitë rezidenciale të objekteve----- | 0.15% |
| 1.6 Për njësitë komerciale të parcelave----- | 0.17% |
| 1.7 Për njësi komerciale të objekteve----- | 0.17% |
| 1.8 Për njësitë industriale të parcelave----- | 0.15% |
| 1.9 Për njësitë industriale të objekteve----- | 0.15% |

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim – Sektori i Tatimit në Pronë.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për Procedurat e Hartimi dhe Publikimi të Akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë, fillon të zbatohet nga 1 janari 2024.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. Drejtorisë së Financave; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I
Bekim Azizi